



Prishtinë, 15.08.2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_111\_2008

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Nenin 15, 26 dhe Kreut 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 3 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe
3. Aplikacionit për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të datës 07.04.2008 të ndërmarrjes ECP-TIM Doo, me adresë Zona Industriale, Vizbegovo p.n, Shkup, Republika e Maqedonisë, me Përfaqësi në Prishtinë, Veternik/Zona Industriale, **në seancën e mbajtur më datë 15 gusht 2008, nxori këtë:**

**VENDIM**

1. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes ECP-TIM Doo.
1. Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 07.04.2008 ka pranuar nga përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë ECP-TIM Doo aplikacionin për licencë Furnizim/Tregti me energji elektrike.
2. ZRRE me datë 08.04.2008 dhe 17.04.2008 ka bërë vlerësimin në detaje të çdo dëshmie të dërguar dhe ka vlerësuar se aplikacioni nuk është komplet, dhe ka kërkuar nga aplikuesi që të dërgoi dëshmitë e kërkuara.
3. Pas pranimit të dëshmive të kërkuara sipas komunikimeve nën pikën 2, ZRRE me datë 21.04.2008 ka vlerësuar se aplikacioni është kompletuar dhe në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregulli për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin e aplikueshëm për energjinë në Kosovë.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqur mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE:

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar